



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 87-Shtator- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - [http://kk.rks-gov.net/malisheve/
www.malisheva-komuna.org](http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org)



Pamje nga rregullimi i shtratit të përroskës në qytet



Përmbajtja

Kryetari Kilaj: Vit i suksesshëm dhe premtues.....	3
Aktualisht janë kryer apo po vazhdojnë punimet në shumë projekte kapitale	4
Mbahet sesioni i parë në lidhje me formimin e Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi	5
Gjatë verës janë ndihmuar 210 raste me ujë për pije	6
Kërkohej kujdes i shtuar në trafik	7
U mbajt dëgjimi publik në lidhje me draft buxhetin e vitit 2011.....	8
PËRMES ZYRËS PËR INFORMIM: SQARIM PËR OPINION	10
Me seancë solemne shënohet Dita Ndërkombëtare e Demokracisë	11
Vlerësohet lartë, pritja e palëve nga ana e kryetarit.....	13
Tejkalohet planifikimi për grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë	13
Rregullohet shtrati i përroit në qytet	14
Stafi i Qendrës së Kompetencës merr eksperience në Norvegji	15
Me një varg aktivitete shënohet Dita e Rinisë.....	16
Miratohet projekt-buxheti i komunës për vitin 2011	17
EVSB, për një ambient të sigurt në bashkësi	18
Përkujtohet Dr.Shpëtim Robaj në 12 vjetorin e rënies	19

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor

Kryetari Kilaj: Vit i suksesshëm dhe premtues

Malishevë, 1 shtator



Me rastin e fillimit vitit të ri akademik, kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka adresuar një urim tek nxënësit dhe mësimitdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të komunës.

Me këtë rast z. Kilaj është shprehur se ndihet i kënaqur dhe këtë vit e vlerëson si të suksesshëm dhe premtues. “ Ky vit i ri shkollor/akademik, është një ndër vitet më

të suksesshëm dhe vit premtues, për faktin e ndërtimit të disa shkolla të reja, me standarde bashkëkohore”. Në këtë kontekst kryetari i komunës së Malishevës, ka përmendur shkollën e mesme profesionale e njohur me emrin Qendra e Kompetencës, pastaj shkollën fillore në Mleqan dhe atë në Senik.

Po ashtu sipas z. Kilaj edhe këtë vit sikur edhe vitet tjera, nuk ka mbetur dhe nuk do të mbetet asnjë nxënës jashtë bankave shkollore, ndërkohë që do të vazhdohej edhe mbështetja e nxënësve (nëpër lokalitete më të thella), në lidhje me sigurimin e transportit, si në Tërpezë, Janqisht, Shkozë, Panorc, Banjë, etj.

Po sot, drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Isuf Morina, ka vizituar disa nga shkollat e komunës sonë, për të parë nga afër fillimin e vitit të ri shkollor 2010-2011 dhe sipas tij “ procesi mësimor ka filluar normalisht dhe pa probleme”.

Mësimi ka filluar në 36 shkolla fillore dhe të mesme të ulët dhe në dy shkollat e mesme, kurse mësimi në Qendrën e Kompetencës do të fillojë në muajin tetor.

Në territorin e Komunës së Malishevës janë gjithsej tri shkolla të nivelit të mesëm, 36 shkolla fillore dhe të mesme të ulët dhe pesë paralele të ndara që funksionojnë në kuadër

të këtyre shkollave, ndërsa të përfshirë në procesin mësimor, janë mbi 18 mijë nxënës nga niveli parashkollor deri në atë të mesëm.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Aktualisht janë kryer apo po vazhdojnë punimet në shumë projekte kapitale

Malishevë, 6 shtator

Në mbledhjen e sotme, të Këshillit të Drejtorëve, është raportuar për një varg projektesh që janë përfunduar ose edhe që janë në përfundim, por edhe për të tjera, për të cilat pritet të fillojnë së realizuari.

Kryetari i komunës, Isni Kilaj, i cili e ka kryesuar takimin, ka diskutuar për një varg çështjes të natyrës së lartpërmendur.

“Jemi duke punuar që të kemi sukses në inaugurimin e shkollës së mesme me 5 tetor, ndërkohë





që janë ndërtuar edhe dy shkolla të reja në Mleqan e Senik, kurse është nënshkruar marrëveshja me USAID-in për aneksin e shkollës fillore në Maralisë, dhe jemi në pritje edhe për arritjen e marrëveshjes edhe për shkollën e Vërmicës”, kështu është shprehur kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve.

Është diskutuar edhe për punët dhe projektet tjera, si psh. ndërtimi i Qendrës së Biznesit, për të cilën është nënshkruar marrëveshja me Agjencionin Rajonal për Zhvillim-AZHR, ujësjellësi në Turjakë, vazhdimi i punimeve të kolektorit të ujërave të zeza, ndërkohë që është shprehur optimizmi që së bashku me USAID-in të vazhdohet edhe ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Kijevë, Bubavec e Drenovc. Gjithashtu për vitin tjetër është planifikuar edhe ndërtimi i aneksit të objektit të komunës.

U raportua edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me fillimin e procesit mësimor, inspektimin e rasteve të ndryshme nga ana e inspektoratit, pastaj për punën dhe intervenimet e Shërbimit të Zjarifikësve dhe Shpëtimit-SHZSH, etj.

Në fund të takimit, kryetari Kilaj, është ndalur edhe te konferenca e LDK-së, dega në Malishevë, e publikuar në shtypin e sotëm, krerët e së cilëve kontestojnë përzgjedhjen e stafit arsimor nëpër shkollat e komunës së Malishevës. “Akuzat e bëra në një konferencë të degës së LDK-së, apo më mirë të themi të familjes Kastrati, nuk qëndrojnë dhe janë të pabaza. Dihet se për çdo vit konkurrenca është më e fortë, dhe mësuesit duhet t’i nënshtrohen edhe rikualifikimeve plotësuese që i kërkon koha, me qëllim që të mund të jenë konkurrent. Drejtoria e Arsimit dhe Qeveria e Komunës, nuk përdorin ndikimin politik në përzgjedhjen e mësimdhënësve”, ka përfunduar kryetari Kilaj.

Mbahet sesioni i parë në lidhje me formimin e Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi

Malishevë, 7 shtator

Me iniciativën e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-ve, ICITAP, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Komunën e Malishevës dhe Policinë e Kosovës, sot është mbajtur një takim orientues, përmes të cilit është bërë i njohur qëllimi i projektit që ka të bëjë me themelimin e Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi- EVSB.



EVSB-të përfshijnë zyrtar të policisë, zyrtarë komunal dhe udhëheqës të bashkësisë (përfshirë përfaqësuesit e rinisë, grave dhe bashkësive jo shumicë), të cilët punojnë së bashku që të identifikojnë dhe adresojnë çështjet e krimit, sigurisë dhe kualitetin e jetës për të arritur qëllimin e përbashkët për një bashkësi të sigurt.

Sipas, Remzije Ibrahimit, nga ICITAP, “Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB), është një projekt që ka për qëllim iniciimin e bashkëveprimit në mes të policisë dhe qytetarëve me qëllim që të zvogëlohet shkalla e krimit dhe të rritet mirëqenia dhe siguria në bashkësi”.

Pjesëmarrësit e EVSB-së, do të kalojnë përmes trajnimeve që do të mbahen në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), në Vushtrri.

Trajnimi do të përfshijë filozofinë dhe përfitimet e policisë duke punuar në partneritet me bashkësinë, ndërtimin e konsensusit; strategjitë për të punuar në mënyrë efektive si ekip; identifikimin e resurseve dhe shfrytëzimi i problemit dhe zgjidhja e tij.

Vlen të përmendet se kjo iniciativë është mbështetur edhe nga kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj, dhe u.d. i komandantit të Policisë në Malishevë, Bekim Begaj, të cilët ishin të pranishëm në takim.

Sipas kryetarit Kilaj “kjo nismë është në të mirë të qytetarëve, edhe pse Malisheva si komunë deri më tani njihet si njëra ndër zonat më të qeta në vend, sa i paketë sigurisë. Mirëpo në lidhje me këtë projekt, duhet të kontribuojmë të gjithë, e edhe qytetarët duhet të ndihmojnë në bartjen e informatave, të cilat janë në dëm të shoqërisë, tek policia. Unë jam në mbështetje të këtyre ekipeve”, është shprehur kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj.

Edhe u.d.i komandantit të Policisë së Kosovës, stacioni në Malishevë, Bekim Begaj, ka falënderuar për këtë nismë, duke u shprehur se “policia është populli, populli është policia.

Të pranishëm në këtë sesion, ishin edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Divizioni për Siguri në Bashkësi.

Gjatë verës janë ndihmuar 210 raste me ujë për pije

Malishevë, 10 shtator

Komuna e Malishevës, gjatë periudhës së thatësisë, ka intervenuar në 210 raste, duke siguruar ujin për pije, kryesisht për familjet të cilat janë raste sociale dhe nuk kanë mundësi materiale të sigurojnë një gjë të tillë.

Sipas drejtorit të Drejtorisë Komunale për Shërbime Publike, Alban Kastrati, “janë realizuar 210 kërkesa të qytetarëve për sigurimin e ujit për pije dhe të gjitha këto janë të evidentuara si familje me gjendje të rëndë sociale”.

Më tej drejtori Kastrati ka bërë të ditur se “ka pasur edhe raste të refuzimit të kërkesave, pasi ato janë konfirmuar se nuk janë raste sociale dhe kanë mundësi të sigurojnë ujin për pije, mirëpo ato janë raste të pakta”.

Sipas tij “krahasuar me javët e kaluara, gjatë javës së fundit ka rënë fluksi i qytetarëve që kërkojnë t’u sigurohet uji për pije, kjo për arsye të uljes së temperaturave dhe shiut të pakët që ka rënë para disa ditëve.

Kërkohet kujdes i shtuar në trafik

Malishevë, 14 shtator



Situata e sigurisë së përgjithshme, në territorin e Komunës së Malishevës, nga anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), u cilësua e qetë dhe stabile, ndërsa shqetësim vazhdon të mbetet siguria në trafik.

Lidhur me këtë zëvendëskryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, kërkoi që Policia e Kosovës të merr masa shtesë për parandalimin e aksidenteve në trafik.



“E falënderoi Policinë e Kosovës, FSK-në dhe të gjitha organet përgjegjëse për krijimin e një ambienti shumë të sigurt dhe të qetë në territorin e Komunës së Malishevës”, tha në fjalën e tij zëvendëskryetari Mazreku.

Drejtori për Mbrotje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, njoftoi për rastet e intervenimeve nga Shërbimi i Zjarrfikëseve, përderisa në një rast zjarri, ka pasur tre të lënduar.

“Gjatë muajit gusht, kemi pasur një rast të aksidentit me fatalitet, ndërsa gjatë këtij viti janë regjistruar gjashtë raste të vdekjeve nga aksidentet në komunikacion”, ka raportuar Bekim Begaj, u.d. i komandantit të stacionit policor në Malishevë.

Sipas Begajt shqetësuese vazhdon të mbetet edhe shkrepja e armëve gjatë ahengjeve familjare, edhe pse gjatë këtij viti ka pasur me pak raste, por duhet të vazhdohet me vetëdijësimin e qytetarëve.

Një shqetësim tjetër i ngritur nga anëtarët e KKSB-së, ishte prania mjaft e madhe e qenve endacak dhe nevoja për largimin e tyre, pasi në veçanti janë të kërcënuar fëmijët gjatë rrugës për në shkollë. Po ashtu një shqetësim tjetër i ngritur ishte edhe djegia e hamulloreve nga vet pronarët e pronave.

Përveç përfaqësuesve të komunës, Policisë së Kosovës-Stacioni në Malishevë, FSK-së, OJQ-ve, në mbledhjen e gjashtë për këtë vit, të KKSB-së, në takimin e sotëm kanë marr pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Organizuar nga Drejtoria Komunale e Financave

U mbajt dëgjimi publik në lidhje më draft buxhetin e vitit 2011

Malishevë, 14 shtator

Organizuar nga Drejtoria Komunale e Financave, sot është mbajtur dëgjimi publik për draft buxhetin e vitit 2011.

Fillimisht drejtori i kësaj drejtorie Vesel Krasniqi, i ka përshëndetur të pranishmit për pjesëmarrje, duke shprehur paraprakisht edhe pakënaqësinë e mos interesimit të një

pjesëmarrje më masive nga ana e qytetarëve. Më pas Krasniqi, ka bërë një elaborim të draft buxhetit, duke bërë të ditur totalin për vitin e ardhshëm, dhe kategoritë e shpërndarjes së totalit.

“Buxheti komunal, përbëhet nga granti qeveritar, granti i të hyrave vetanake dhe financimet tjera”, kështu ka bërë të ditur drejtori Krasniqi, i cili njëkohësisht ka njoftuar se “kufijtë fillestar të buxhetit, caktohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në nivel shteti”.



Buxheti komunal, i cili në total arrin shumën 8.048.888 euro, sikur u tha edhe më lartë kategorizohet në pesë drejtime. Në paga dhe meditje shkojnë 4.364.578 euro, në mallra dhe shërbime 713.805 euro, në shpenzime komunale 156.676 euro, në subvencione dhe transfero 61.888 euro dhe në investime kapitale 2. 751.947 euro.

Pasi është bërë prezantimi i draft buxhetit për vitin 2011, nga ana e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Financave, takimi ka vazhduar me disa pyetje nga ana e qytetarëve për çka drejtori Krasniqi, ka dhënë shpjegimet e duhura.

KOMUNA E MALISHEVËS
DREJTORIA PËR ARSIM DHE EDUKIM



PËRMES ZYRËS PËR INFORMIM: SQARIM PËR OPINION

MALISHEVË, 15 SHTATOR

Kohëve të fundit, në medie të shkruara dhe elektronike po dëgjohen zëra, kinse, me rastin e pranimin të kuadrit arsimor, po udhëhiqet një fushatë për spastrime politike, për më tepër se nuk po përfillen as Udhëzimet Administrative dhe politikat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës-MASHTK-së. Fatmirësisht, janë zëra të veçuar madje krejtësisht të vetmuar.

Drejtorja për Arsim dhe Edukim në Komunën e Malishevës, as edhe një herë nuk ka udhëhequr politikë spastrimi të kuadrit arsimor mbi bazë të përcaktimeve dhe bindjeve partiake. Përkundrazi, në të gjitha veprimet e saj, janë bërë përpjekje për flakjen e politikës nga institucionet shkollore. Dhe ky objektivi yni është arritur.

Sa i përket zbatimit të politikave të MASHTK-së dhe bashkëpunimit me këtë Ministri, e themi më bindje të plotë, se janë në nivelin më të mirë të mundshëm. Këtë e shprehin haptas përfaqësues e zyrtarë të shumtë nga Departamentet e MASHTK-së.

- Sa i përket vitit të ri shkollor 2010-2011, kuadri arsimor është pranuar mbi baza të kualifikimit. E veçanta e këtij viti është se, konkurrenca ka qenë tejte e madhe, si në numër, ashtu edhe në nivel kualifikimi. Mbi 700 ka qenë numri i kandidatëve, të cilët kanë konkurruar për 160 vende pune;
- Arsyja pse ka pasur shkurtime të vendeve të punës është se, janë zvogëluar paralelet e klasave të dhjeta (10-ta), në Gjimnazin “A. Frashëri”, nga 24 paralele që ishin në vitin shkollor 2009-2010, në vetëm 10 paralele për këtë vit. Kjo është bërë ngase 12 paralele, kanë kaluar në Qendrën e Kompetencës për Arsim dhe Aftësim Profesional.

Andaj, me një përmbledhje, nga e tërë kjo që u tha më lart, njoftojmë opinionin, se askush nuk është larguar, apo pranuar mbi bazë të përkatësisë partiake.

Me seancë solemne shënohet Dita Ndërkombëtare e Demokracisë

Malishevë, 15 shtator



Organizuar nga OSBE dhe KK i Malishevës, është mbajtur një seancë solemne, për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë. Në këtë seancë, përveç këshilltarëve komunal, mori pjesë edhe kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, pastaj përfaqësues të shoqërisë civile, mediet, nxënës të shkollave të mesme.

Në këtë organizim, fjalime lidhur me ditën e demokracinë, kanë mbajtur Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, pastaj përfaqësuesit e grupeve parlamentare në KK të Malishevës, të shoqërisë civile dhe përfaqësues të OSBE-së.

Enver Hoti, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, e ka quajtur të kënaqshme demokracinë, e cila respektohet nga ana e Kuvendit Komunal, konform ligjeve dhe akteve tjera kushtetuese, por sipas tij, ka akoma punë në zhvillimin e mëtutjeshëm të saj. Demokracia varet nga shumë faktor, siç janë zhvillimi ekonomik dhe social. Kuvendi Komunal duhet të punoj në shtrirjen e debatit me qytetar, krijimin e komiteteve konsultative apo këshillëdhënëse, në fushën e arsimit, shëndetësisë, e pse jo edhe të urbanizmit.

Besnik Hoti, këshilltar i LDK-së, ka folur për format e sistemeve të pushtetit, ndërsa për demokracinë tha se është një sfidë e madhe e çdo shoqërie, pasi shkelen të drejtat elementare të njeriut.



Më pas, kanë folur edhe këshilltarët tjerë, si Luan Morina, Fadil Shala, Sami Kafexholli e Naim Morina.

Olivier Bricet, zyrtar i lartë i OSBE-së, për regjionin e Prizrenit, duke folur për demokracinë, tha se është një proces i gjatë i ngadalshëm, dhe i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit.

“Në vendin tim në Francë, na është dashur një shekull për të zhvilluar një sistem demokratik, nga 1789 me Revolucionin Borgjez Francez, deri në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë. Si e shoh Kosovën, fatkeqësisht këtu nuk ka pasur demokraci deri më 1999, prandaj duhet të merren hapa për zhvillimin e demokracisë, ku është një rrugë e gjatë. Duhet të respektoni njëri tjetrin, ju duhet të respektoni opozitën dhe anasjelltas opozita duhet të respektoj pozitën, sepse demokracia është një qark, që rrotullohet gjatë gjithë kohës, si vet jeta. Idealisht, demokracia zhvillohet mirë me zhvillimin ekonomik. Siç e dini, zhvillimi ekonomik, për momentin është një brengë, prandaj është një rrugë e vështirë për zhvillimin e demokracisë”, tha Bricet.

Në pjesën e dytë të kësaj seance, kryetari Kilaj dhe zyrtarët e OSBE-së, janë përgjigjur në pyetjet e të pranishmëve, të cilat kishin të bënin me demokracinë.

Në vazhdim fjalimi i kryetarit, i mbajtur në seancën solemne, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë.

I nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë, të respektuar, përfaqësues të OSBE-së, gazetarë dhe të gjithë Ju të pranishëm.më lejoni që sot në ditën botërore të demokracisë, të uroj Ju dhe gjithë popullin tim për lirinë e fituar, për ëndrrën e realizuar që populli ynë me shekuj kishte derdhur gjak e djersë, për liri e demokraci.

Vet fjala demokraci do të thotë sundim i popullit nga fjala greke, që do të thotë ka rrënjët në Greqinë e lashtë. Por demokracia është synuar që nga krijimi i fiseve të para duke zgjedhur udhëheqësin e tyre e deri te krijimi i popujve dhe shtetit ku vazhdimisht janë bërë përpjekje që të krijohet një sistem demokratik i qeverisjes. Që nga krijimi i Senateve dhe Parlamenteve edhe janë keqpëdorur sundimet në emër të popullit. Kanë kaluar sisteme mbretëri, autokraci, monarki, diktaturë, për të ardhur te demokracia. Në emër të sundimit të popullit, u krijua socializmi, i cili sundoi një pjesë të madhe të botës, për më shumë se 50 vite. Por ai deformuar që në fillim nga vet themeluesi i tij, Lenini. Socializmi prodhoi diktator të mëdhenj, që do të mbahen mend, por shqiptarët ishin populli që e vuajti më së shumti diktaturën. Kosova përjetoi dhunë me përmasa të gjenocidit, dëbimit dhe shfarosjes, nga diktatura e Millosheviqit.

Malisheva e ndërtuar pas luftës,ndërtoi institucionet demokratike të qeverisjes lokale. Vitet e para ishin vite të rënda për demokracinë e ushqyer me ekstremizëm dhe me urrejtje të pa përmbytshme. Por me kalimin e viteve, me përmirësimin e legjislaturës



qeverisëse, u bënë përparime të shumta dhe sot, besoj, kemi një parlamentarizëm dhe demokraci të kënaqshme në Malishevë.

Demokraci është kur shumica fituese në zgjedhje, ka pushtetin dhe qeverisë. Demokratike është aprovimi me shumicë. Demokratike është që pakica të respektoj fituesin. Demokratike është që pozita ta dëgjoj dhe të mbështes opozitën në idetë e mira, projektet bindëse dhe qëllimet humane. Bota ka provuar shumë sisteme e mënyra të qeverisjes, por sistemi demokratik ka triumfuar vazhdimisht dhe sot popujt që kanë fituar lirinë dhe sistemin demokratik të qeverisjes, prosperojnë në jetë, të tjerët që nuk e kanë këto, po luftojnë deri në arritjen e tyre. Jam i sigurt se sistemi demokratik, do të përmirësohet bashkë me kohën, por do të ekzistoj sa do të ketë nevojë për shtetin. Ju faleminderit.

Vlerësohet lartë, pritja e palëve nga ana e kryetarit

Malishevë, 16 shtator

Edhe gjatë ditës së sotme, sikur edhe të enjteve të tjera, në pritjen e palëve në zyrën e kryetarit të komunës, z.Isni Kilaj, shumë qytetarë kanë prezantuar para tij, shqetësimet e dhe kërkesat e ndryshme, për të cilat kryetari, ka ofruar ndihmën për zgjidhjen e tyre, në veçanti për kërkesat shumë urgjente.

Pritja e palëve, këtë të enjte ka filluar për një orët më herët (nga ora nëntë) se ditëve tjera, përdërisa kërkesat e qytetarëve kanë qenë nga më të ndryshmet, por më të shumtat, si zakonisht ishin ato, socio-ekonomike, pastaj për rregullimin e infrastrukturës si, rrugë brenda fshatit, kanalizime dhe të tjera.

Vlen të theksohet se pritja e palëve nga ana e kryetarit të komunës, është vlerësuar lartë nga shumë qarqe, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, por edhe edhe nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Ky vlerësim është përsëritur edhe gjatë ditës së djeshme, në kuadër të shënimit të Ditës së Demokracisë.

Tejkalohet planifikimi për grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Malishevë, 22 shtator

Zyra e tatimit në pronë, në Komunën e Malishevës, ka tejkaluar planifikimin vjetor të inkasimit, për 35.5 për qind më shumë se planifikimi vjetor për këtë vit.

Sipas përgjegjësit të zyrës së tatimit në pronë, Avni Krasniqi, deri më sot janë inkasuar 159 mijë euro, ndërsa për këtë vit, të planifikuara kanë qenë 120 mijë euro. “Shprehur në përqindje e kemi tejkaluar planifikimin vjetor për 35.5 për qind”, tha Krasniqi.

Deri në gjysmën e vitit, kjo zyre kishte arkëtuar 109 609 euro, apo 91.34 për qind të shumës totale të planifikuar për vitin 2010.



Zyra e tatimit në pronë, çdo vit tejkalon planifikim dhe jo rrallë është shpërblyer për këtë, duke fituar grante qeveritare për realizimin e planifikimeve vjetore.

”Gatishmëria vet qytetarëve për pagesë, ka ndikuar në këtë rritje, por këtu hyn edhe puna efektive e gjithë stafit të zyrës dhe angazhimi ynë në kryerjen e shërbimeve”, tha Krasniqi.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme për grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë, është edhe kthimi i atyre mjeteve tek vet qytetarët përmes investimeve dhe realizmit të projekteve të ndryshme.

Rregullohet shtrati i përroit në qytet

Malishevë, 22 shtator

Po vazhdojnë punimet në rregullimin e shtratit të përroit, që kalon nëpër qytet dhe që vjen nga vargmalet e Berishës, për tu derdhur në lumin Mirusha.

Rregullimin e shtratit të përroit, e ka financuar Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe kushton rreth 100 mijë euro, kjo në kuadër të programit të kësaj ministrie, për punësimin sezonal të punë kërkuarësve, përmes Zyrës për Punësim në Malishevë, ku janë punësuar disa punëkërkuarës.

Përveç punësimit të punëkërkuesve, ky projekt, ka për qëllimin edhe rregullimin e ambienteve dhe hapësirave në Malishevë.

“Në mesin e disa projekteve që janë duke u realizuar dhe që kanë për qëllim rregullimin e hapësirave në qytet, është rregullimi i shtratit të përroit që kalon gati në mes të qytetit”, tha Esat Paçarizi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm në Malishevë. “Shtrati që po rregullohet momentalisht ka një gjatësi prej 300 metrave, ndërsa pjesa më e madhe e rregullimit të shtratit është kryer”, tha Paçarizi.



“Përveç rregullimit të hapësirës, qëllim tjetër me rëndësi është edhe evitimi i vërshimeve, që shkakon ky përrua, problem me të cilin përballemi çdo vit”, tha drejtori Paçarizi.

Stafi i Qendrës së Kompetencës merr eksperience në Norvegji

Malishevë, 27 shtator

Stafi menaxhues dhe arsimor i Qendrës së Kompetencës, është kthyer nga vizita studimore që kanë bërë në disa prej shkollave të Norvegjisë, prej ku kanë marrë përvojën e këtyre shkollave profesionale, për t’u bartur në Qendrën e Kompetencës në Malishevë.

Sipas drejtorit të Qendrës së Kompetencës, Besim Dobruna, stafi i përbërë nga 13 mësimdhënës dhe menaxherët e Qendrës së Kompetencës, kanë bërë këtë vizitë studimore në Norvegji, për tu njohur me mënyrën e funksionimit të shkollave të ngjashme profesionale, me Qendren e



Kompetencës që do të filloj punën në Malishevë.

“Kemi parë nga afër punën dhe funksionimin e procesit mësimor, të aftësimit profesional dhe secili mësimdhënës ka pasur mundësi të shoh praktikisht punën në këto shkolla, organizimin e brendshëm, mësimin dhe mbarëvajtjen e orëve mësimore”, ka njoftuar drejtori Dobruna. “Eksperienca në procesin mësimor, që ka të bëjë me praktikën profesionale, e që dallon shumë me praktikat te ne, duhet të aplikohet edhe në Qendrën e Kompetencës”, tha më tej z. Dobruna, duke marrë për bazë përvojën dhe praktikat në Norvegji.

Gjatë kësaj vizite, stafi i Qendrës së Kompetencës, ka vizituar edhe Universitetin Akershouse në Oslo të Norvegjisë.

Me një varg aktivitete shënohet Dita e Rinisë

Malishevë, 28 shtator

Në kuadër të Muajit të Rinisë në Kosovë, sot këto aktivitete kanë vazhduar në Malishevë, organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rinore të Malishevës, klubet sportive dhe grupet kulturore në komunën tonë.



Me rastin e hapjes së Ditës së Rinisë në Malishevë, drejtori për Kulturë Rini dhe Sport në Malishevë, Mevludin Mazreku, tha se “rinia ka nevojë për fuqizim, andaj ne, e kemi përkushtimin e për të dhënë mbështetje në këtë drejtim”.

Drejtori Mazreku, këtë përkushtim e bazoj në investimet në objekte kulturore dhe sportive, ku të rinjtë mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre, përdorisa të gjitha

grupet dhe organizatat rinore, brenda mundësive financiare, janë duke u mbështetur në aktivitetet e tyre.

“Rinia, meriton mbështetje financiare e morale, rinia meriton të përfshihet në proceset e vendimmarrjes, në mënyrë që zëri i saj të dëgjohet dhe të jetë pjesë aktive e proceseve që ndodhin”, tha me tutje drejtori Mazreku.

Në anën tjetër, zyrtari për politika rinore në Ministrinë për Kulturë Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Vedat Jashari, tha se kjo ministri është e përkushtuar në lobimin dhe në zhvillimin e qasjes së rinisë.

Gjatë ditës së sotme janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, kulturore, sportive, humanitare dhe argëtuese, si: gara, ekspozita, debate, programe artistike, dhurim vullnetar i gjakut dhe në mbrëmje një koncert i madh në qendër të qytetit.

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës

Miratohet projekt-buxheti i komunës për vitin 2011

Malishevë, 29 shtator



Në mbledhjen e sotme, e IX-ta (nënta), e Kuvendit të Komunës së Malishevës, kryetari i komunës z. Isni Kilaj, ka prezantuar para deputetëve raportin e punës gjashtëmujore për vitin 2010, ndërkohë që janë miratuar, por edhe kanë rënë disa pika të tjera të rendit të ditës të parapara për sot.

Rendi i ditës për sot ishte: Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Raporti gjashtëmujor (Janar –Qershor), i Kryetarit të Komunës së Malishevës për vitin 2010; Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2011; Shqyrtimi dhe miratimi i projekt –Buxhetit të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2011(të cilat janë miratuar). Ndërsa nuk kanë marrë votat e duhura këto nënpika: fillimi i procedurave për ndryshimin e Statutit të Komunës së Malishevës dhe fillimi i procedurave për ndryshime, në Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës. Më pastaj është miratuar kërkesa e grupit parlamentar të LDK-së, për formimin e Komitetit për Arsim dhe Kulturë, me përbërje prej pesë anëtarëve.

Është miratuar edhe kërkesa e parashtruar nga z. Hamëz Halil Morina nga Drenoci, për ndarjen e truallit për ndërtim të shtëpisë për banim në Malishevë, dhe kërkesa e parashtruar nga BEN-AF “ sh.p.k me seli në Suharekë, për dhënien e pëlqimit për shfrytëzim të tokës-pronës së paluajtshme komunale në Malishevë (e pa përfunduar nga mbledhja e kaluar).

(raportin e punës dhe draft buxhetin për vitin 2011, i gjeni në ueb-faqen zyrtare të komunës)

EVSB, për një ambient të sigurt në bashkësi

Malishevë, 30 shtator

Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB), pas trajnimit në Vushtrri, mbajti takimin e radhës në Malishevë, në mënyrë që të identifikoj problemet që lidhen me sigurinë e përgjithshme të bashkësive, në raste të tyre të ofroj zgjidhje.

“Formimi i EVSB-ve, është një hap i rëndësishëm në ofrimin e sigurisë në bashkësi dhe për këtë çështje, komuna ofron mbështetje në punën tuaj”, tha zëvendëskryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, në fjalën tij.



Ndërsa A. Mikullovcu nga IC ITAP tha se “EVSB-të janë formuar në 26 komuna të Kosovës, përmes projekteve të së cilave, synojmë të rrisim sigurinë në bashkësi”.

Qëllimi i këtij takimi pra ishte identifikimi i nevojave të komunitetit në krijimin e sigurisë, ndërsa misioni ka të bëjë me “Identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve për një ambient të qetë dhe të sigurt”.

Përkujtohet Dr.Shpëtim Robaj në 12 vjetorin e rënies

Malishevë, 30 shtator

Në 12 vjetorin e rënies, sot është përkujtuar dëshmori i kombit Dr.Shpëtim Robaj, i cili ra në përpjekje për ta ndihmuar popullatën e Drenicës, pas masakrës së Abrisë, më 30 shtator 1998, me çrast, është vlerësuar lartë jeta dhe vepra e tij, si dhe kontributi i dhënë gjatë luftës së UÇK-së.

Dr.Shpëtim Robaj, u cilësua si organizatori kryesor për furnizimin e spitaleve ushtarake të UÇK-së dhe ndihmës shëndetësore për popullatën civile, gjatë luftës së UÇK-së, për çlirim. “Jo gjithmonë jeta përfundon me vdekje. Ata që janë pjesë e historisë, mbesin të gjallë”, tha mes tjerash Besim Zogaj, drejtor i QKMF-së “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishevë.

“Shpëtimi punoj në spitalet ushtarake, si në Gjarak, Breshanc, Likoc dhe vende tjera, si



dhe ju doli në ndihmë edhe popullatës civile gjatë luftës”, tha Rexhep Mazreku, zëvendës kryetar i komunës së Malishevës, duke folur për veprën e dr.Shpëtim Robajt dhe kontributit të tij në luftë.

“Dr. Shpëtim Robaj, ndër të parët ju bashkëngjijt luftës për liri dhe i takoi gjeneratës që luftoi për çlirimin e vendit, gjeneratë e cila më pas ndërtoi paqen”, tha Fatmir

Shurdhaj, në emër të OVL të UÇK-së. “Shpëtim Robaj u tregu shpëtimtar dhe ra heroikisht, duke u bërë një shembull i sakrificës”, tha Shurdhaj.

Eshref Osmani dhe Cenë Bytyçi, bashkëpuntorë të afërt me dr. Shpëtimin, kujtuan punën e përbashkët me dr.Shpëtimin, si dhe e quajtën “organizatori kryesor për furnizimin e spitaleve ushtarake dhe në dhënien e ndihmës shëndetësore për popullatën civile, në zonat më të thella të luftës.

“Me këtë përkujtim, ju na ngushëlloni neve si familje, prandaj unë ju falënderoj të gjithëve për këtë përkujtim”, tha Zeqir Robaj, babai i doktor Shpëtim.

Me pas, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), dha mirënjohje për kontribut në shëndetësi, për Dr.Sali Ahmetin, infektolog dhe falënderuan Klinikën Infektive në QKUK, për trajtimin e etheve hemorragjike.

Për kontribut në shëndetësi në Malishevë, u nderuan edhe Sanije Desku dhe Shefqet Paçarizi. Po ashtu, për kontribut në shëndetësi, post mortum, u ndanë mirënjohje edhe për mjekët Seherie Gashi dhe Haki Balaj.

Në fund u vendosën lule pranë bustit të dr.Shpëtim Robajt në oborrin e QKMF-së “Dr.Shpëtim Robaj”, në Malishevë.